



HULUMTIMI I OPINIONIT PUBLIK MES PRINDËRVE PËR PËRFSHIRJEN E PËRMBAJTJEVE TË REJA NË MËSIM NGA FUSHA E EDUKATËS GJITHËPËRFSHIRËSE SEKSUALE

Raport nga hulumtimi sasior



CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.653-055.52:37.015]:613.88(497.7)“2019“(047 .31)
37.015:613.88]:316.653-055.52(497.7)“2019“(047 .31)

HULUMTIMI i opinionit publik mes prindërve për përfshirjen e
përmbajtjeve të reja në mësim nga fusha e edukatës gjithëpërfshirëse
seksuale [Електронски извор] : raport nga hulumtimi sasior. - Shkup :
Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim H.E.R.A, 2019

Начин на пристап (URL): <http://hera.org.mk>. - Текст во PDF формат,
содржи 29 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот
на ден 22.10.2019

ISBN 978-608-4859-21-5

а) Сексуално образование - Јавно мислење - Родители - Македонија - 2019
- Истражувања
COBISS.MK-ID 111383306

Përmbajtja

1	Hyrje dhe qëllimi i projektit	4
1.1	Përmbajtja e instrumentit për hulumtim	5
2	Gjetjet kryesore	9
3	Analiza dhe rezultatet	11
4	Metodologjia	19
5	Struktura e variabileve	22
6	Instrumenti për hulumtimin – Pyetësi	24

1 HYRJE DHE QËLLIMI I PROJEKTIT

Propozim modeli dhe pilot programi për përfshirjen e edukimit gjithëpërfshirës seksual në shkollat fillore dhe të mesme në vend, që gjatë vitit 2018 u përpiluan nga Byroja për zhvillimin e arsimit, HERA dhe grup ekspertësh, propozojnë program të veçantë për edukimin seksual, që do të mësohej si lëndë zgjedhore në arsimin fillor. Lënda nuk do të vlerësohej me notë, ndërsa do ta ligjëronin arsimtarë dhe/ose përfaqësues të shërbimeve profesionale nga shkolla, të cilët vullnetarisht do të paraqiteshin për trajnim dhe për realizimin e saj. Propozohet që lënda për edukim seksual të ketë fond të përgjithshëm prej 36 orëve në vjet, ndërsa programi mësimor do t'i përfshinte këto njësi mësimore: gjinia, lidhjet dhe marrëdhëniet, trupi dhe fotografi për trupin, shëndeti seksual dhe riprodhues (HIV, infektimet seksualisht të transmetueshme, kontracesioni), seksualiteti dhe sjellja seksuale, dhuna dhe aspektet qytetare.

Gjithashtu, Byroja për zhvillimin e arsimit, bashkë me HERA dhe grupin punues, propozoi që pilot programi të realizohet në 4 shkolla fillore, para se të përgatitet strategjia dhe plani për përfshirjen e plotë të edukimit gjithëpërfshirës seksual (EGJS) në shkollë. Përndryshe, grupi punues përmendi se edhe pse në fillim fokusi do të ishte në pilot shkollat fillore, me edukimin gjithëpërfshirës seksual duhet të fillohet që në moshën parashkollore.

Sipas raportit “Edukimi seksual në Evropë dhe Azinë Qendrore”, i realizuar në 25 shtete gjatë vitit 2016, nga ana e Qendrës federale për edukim shëndetësor në Gjermani (BZgA) dhe Rrjeti evropian i Federatës ndërkombëtare për planifikim familjar (FNPF EN), në 11 prej 21 shteteve ku ekzistojnë programe shkollore për edukim seksual, kjo është lëndë e obligueshme mësimore. Në 6 shtete lënda është pjesërisht e obligueshme, që do të thotë se nuk është e obligueshme në të gjitha pjesët e vendit ose në të gjitha shkollat. Në 4 shtete lënda është zgjedhore, që do të thotë se nxënësit mund ta zgjedhin, ose ekzistojnë disa opsion alternative.

Në shumicën e vendeve me edukimin seksual fillohet në shkollën fillore dhe vazhdohet në shkollën e mesme. Në vendet me programe tërësisht të zhvilluara për edukim gjithëpërfshirës seksual, të rinjtë kryesisht e cekin shkollën si burim të rëndësishëm të informatave për seksualitetin, ndërsa shkalla e lindjeve në moshën minorene kryesisht janë të ulëta. Në vendet, ku edukimi seksual pothuaj edhe nuk ekziston në shkollë, shkalla e lindjeve në moshën minorene, në përgjithësi, janë mjaft të larta.

Edhe pse përfshirja e edukimit seksual në vend propozohet në tre strategji kombëtare, ky akoma nuk është pjesë e programit të rregullt mësimor. Disa tema dhe aspekte mësohen në lëndët e biologjisë, sociologjisë, edukimit qytetar ose edukimit për shkathtësi jetësore, por informatat që u jepen nxënësve në masë të madhe janë të vjetra dhe të pasakta. Përveç kësaj, qasja e këtillë e përmbajtjeve të integruara të edukimit seksual në shumë lëndë, sipas vlerësimit të Grupit punues, nuk ofron gjithë përfshirje dhe vazhdimësi, e as nuk është ekonomik e as praktik.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij hulumtimi, të zbatuar për nevojat e HERA, e përmes qëndrimeve dhe mendimeve personale që të fitohet mirëkuptim më i mirë për gatishmërinë e prindërve për përfshirjen e përmbajtjeve mësimore ose lëndë zgjedhore në shkollim, të bazuar mbi modelin e edukimit gjithëpërfshirës seksual (EGJS).

Edukimi gjithëpërfshirës seksual është proces i bazuar mbi mësimin dhe të mësuarit përmes programit adekuat mësimor të përpiluar për: aspektet njohëse, emocionale, fizike dhe sociale të seksualitetit. Qëllimi është t’u mundësohet fëmijëve dhe të rinjve që të fitojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera të cilat do t’i aftësojnë: që ta njohin shëndetin e tyre, mirëqenien e tyre dhe dinjitetin e tyre; të zhvillojnë raporte sociale dhe seksuale të cilat do të bazohen mbi respektin; të mund të bëjnë vlerësim sesi burimet e tyre ndikojnë mbi mirëqenien e tyre dhe mirëqenien e të tjerëve; dhe të mësojnë dhe të kuptojnë për të drejtat e tyre, e pastaj edhe të dinë ta sigurojnë mbrojtjen e tyre gjatë jetës¹.

¹ International technical guidance on sexuality education, an evidence-based approach, UNESCO, botim i rishikuar, 2018.

1.1 PËRMBAJTJA E INSTRUMENTIT PËR HULUMTIM

Pyetësi i struktura u përgatit në bashkëpunim me HERA dhe përbëhej prej disa pjesëve:

- 1 Zgjedhja e amvisërisë dhe të anketuarit adekuat;
- 2 Pjesa kryesore;
- 3 Pyetje demografike.

Pyetjet për zgjedhje të amvisërisë dhe të anketuarit adekuat kishin të bëjnë lidhur me atë nëse amvisëria ka fëmijë të moshës deri në 15 vjet dhe nëse mund të bisedohet me prindin ose kujdestarin.

Pjesa kryesore e pyetësorit ishte e përbërë prej dy pjesëve. Në pjesën e parë nga të anketuarit kërkohet ta shprehin mendimin e tyre, se cilat nga 12 temat e ofruara të rinjtë duhet t'i mësojnë në shkollë, e cilat nuk duhet (secila nga temat është e kategorizuar në temë adekuate në suaza të edukimit gjithëpërfshirës seksual – EGJS):

1

Të mësojnë se cilat janë dallimet mes femrës dhe mashkullit dhe çfarë do të thotë trajtim i barabartë dhe barazia;

7

Të kuptojnë se lidhjet seksuale, dëshirat dhe kënaqësia janë dukuri të natyrshme, e jo të turpshme;

2

Të njohin se si vendosen lidhje të shëndetshme partnere të bazuara mbi respektin, e cilat lidhje janë të dëmshme për adoleshentët;

8

Të dinë se si të ballafaqohen me presionet nga mjedisi që të kenë marrëdhënie seksuale;

3

Të dinë cila është rëndësia e dhënies pëlqim gjatë hyrjes në marrëdhënie seksuale, veçanërisht gjatë të parit;

9

Të mësojnë për format e ndryshme të dhunës dhe se dhuna, veçanërisht ndaj vajzave, ka pasoja ndaj gjithë shoqërisë;

4

Të mësojnë çfarë ndryshimesh trupore ndodhin te të dy gjinitë gjatë pubertetit;

10

Të mësojnë se si të mbrohen nga dhuna seksuale në jetën e përditshme dhe dhunën në rrjetet sociale;

5

Të dinë se ku të drejtohen për ndihmë mjekësore në rast të rrezikut nga HIV dhe infektimet seksualisht të transmetueshme;

11

Të dinë si të reagojnë dhe kujt t'i drejtohen kur të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese janë kërcënuar;

6

Të mësojnë për kontracepsionin që të mbrohen nga shtatzënia e padëshiruar;

12

Të dinë se cilat janë pasojat individuale dhe shoqërore nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual.



Në pjesën e dytë të anketuarit duhej ta shprehin qëndrimin e tyre personal me dhënien e pëlqimit në shkallën prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë Nuk pajtohem aspak, ndërsa 5 Pajtohem plotësisht lidhur me shtatë (7) deklaratat që vijojnë:

1

Meshkujt janë ata të cilët kryesisht janë përgjegjës që financiarisht të fitojnë për familjen;

2

Gruaja ka të drejtë të vendos nëse dhe me kë do të hyjë në martesë ose jo;

3

Nëse nuk dëshiron, vajza ka të drejtë ta refuzojë marrëdhënien seksuale me të dashurin e saj;

4

Përdorimi i kontracepsionit është përgjegjësi e të dy partnerëve, e jo vetëm e vajzave;

5

Vajzave nuk u ngjan të masturbojnë;

6

Në raste të caktuara është e arsyeshme që mashkulli ta rrahe gruan e tij;

7

Homoseksualiteti është plotësisht i papranueshëm.

Krahas kësaj, pyetësi përfshiu edhe disa pyetje kyçe demografike, dhe atë: regjioni statistikor, mjedisi i banimit, përkatësia etnike, gjinia, mosha dhe arsimimi.

2 GJETJET KRYESORE

Rezultatet nga ky hulumtim telefonik tregojnë nivel të lartë të pëlqimit nga ana e prindërve ose kujdestarëve të fëmijëve deri në moshën 15 vjeçare për përfshirje me përmbajtje të reja ose lëndë zgjedhore në mësim.

Jashtëzakonisht përqindje e lartë e të anketuarve, që është mes 88 dhe 96%, pajtohen se të rinjtë në shkollë duhet t'i mësojnë të gjitha 12 temat e ofruara, të cilat ishin subjekt i këtij hulumtimi, e të cilat janë pjesë e modelit të edukimit gjithëpërfshirës seksual, kryesisht temat të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e tyre dhe sigurinë në jetën e përditshme (96%), gjegjësisht mbrojtje nga çdo lloj dhune, duke përfshirë edhe atë seksuale, si dhe lidhur me shëndetin e të rinjve, do të thotë mbrojtja nga HIV dhe infektimet seksualisht të transmetueshme.

Gjithsej 88% të prindërve/kujdestarëve të anketuar pajtohen se të rinjtë duhet të dinë cila është rëndësia e dhënies së pëlqimit gjatë hyrjes në marrëdhëniet seksuale, veçanërisht gjatë marrëdhënies së parë. Por nga analiza e rezultateve konstatohet se 12% të anketuarve nuk pajtohen se të rinjtë duhet ta mësojnë këtë temë në shkollë.

Gjinia e të anketuarve, mjedisi ku jetojnë, mosha, regjioni dhe arsimimi nuk kanë ndikim mbi qëndrimin e të anketuarve dhe pëlqimi i tyre që temat e ofruara të jenë pjesë e programeve mësimore në shkollë, derisa përkatësia etnike ndikon mbi mendimin e të anketuarve për një pjesë të temave. Në të vërtetë, të anketuarit me përkatësi etnike maqedonase dukshëm më tepër nga grupet tjera etnike mendojnë se të rinjtë duhet të dinë cila është rëndësia nga dhënia e pëlqimit gjatë hyrjes në marrëdhëniet seksuale, veçanërisht gjatë marrëdhënies së parë (maqedonasit – 90%, shqiptarët – 81%, grupet etnike tjera – 70%), të kuptojnë se lidhjet seksuale, dëshirat dhe kënaqësia janë dukuri të natyrshme, e jo të turpshme (maqedonasit – 94%, shqiptarët – 85%, grupet tjera etnike – 91%), të mësojnë se si të mbrohen nga dhuna seksuale në jetën e përditshme dhe dhuna në rrjet sociale (maqedonasit – 97%, shqiptarët – 93%, grupet tjera etnike – 89%), si dhe të dinë se si të reagojnë dhe kujt t'i drejtohen kur të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese janë të kërcënuara (maqedonasit – 96%, shqiptarët – 91%, grupet tjera etnike

– 89%). Nga ana tjetër, të anketuarit shqiptarë dukshëm më tepër se maqedonasit mendojnë se të rinjtë nuk duhet të dinë se si të ballafaqohen me presionet nga mjedisi që të kenë marrëdhënie seksuale (shqiptarët – 14%, maqedonasit – 7%). Ky hulumtim tregon se më të pranueshme për prindërit janë temat nga fusha e dhunës (siguria) dhe përgjegjësia e ndërsjellë e partnerëve.

Më tej, të dhënat tregojnë se 34% të anketuarve i dëshmojnë rolet tradicionale gjinore mes mashkullit dhe femrës, gjegjësisht mendojnë se meshkujt janë ata që kryesisht janë përgjegjës që të fitojnë për familjen, gjegjësisht 36% të anketuarve pohojnë se vajzave nuk u ngjan që të masturbojnë.

Më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se homoseksualiteti për ata është pothuajse i papranueshëm. Ky rezultat e tregon nivelin akoma më të ulët të pranimit social të njerëzve me orientim tjetër seksual.

3 ANALIZA DHE REZULTATET

Në vazhdim të kësaj pjese të Raportit vijon analiza e hollësishme dhe prezantimi grafik i rezultateve nga hulumtimi për çështje të caktuara.

Siç u theksua paraprakisht, pjesa kryesore e pyetësorit përbëhej prej dy pjesëve. Në pjesën e parë nga të anketuarit është kërkuar që ta shprehin mendimin e tyre rreth asaj se cilat nga 12 temat e ofruara të rinjtë duhet ta mësojnë në shkollë, e cilën jo. Në pjesën e dytë të anketuarit duhej ta shprehin qëndrimin e tyre personal në shkallën prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë Nuk pajtohem aspak, ndërsa 5 Pajtohem plotësisht, lidhur me shtatë (7) deklaratat.

Të gjitha 12 temat e ofruara janë të pranueshme për përqindje mjaft të lartë nga të anketuarit, si tema që të rinjtë duhet t'i mësojnë në shkollë (Grafiku 1). Numri i të anketuarve të cilët pajtohen se temat e ofruara janë diçka që të rinjtë duhet ta mësojnë si përmbajtje të reja ose si pjesë e lëndëve zgjedhore në mësim lëvizë prej 88% të lartë (Të dinë se cila është rëndësia nga dhënia e pëlqimit gjatë hyrjes në marrëdhënie seksuale, veçanërisht gjatë marrëdhënies së parë) dhe 96% (Të mësojnë se si të mbrohen nga dhuna seksuale në jetën e përditshme dhe dhuna në rrjetet sociale; Të mësojnë për format e ndryshme të dhunës dhe se dhuna, veçanërisht ndaj vajzave, ka pasoja ndaj gjithë shoqërisë; Të dinë se ku të drejtohen për ndihmë mjekësore në rast të rrezikut nga HIV dhe infektimet seksualisht të transmetueshme).



Grafiku 1: Temat të cilat të anketuarit mendojnë se të rinjtë duhet ose nuk duhet t'i mësojnë në shkollë - %

Prej 12 temave të ofruara, numri më i madh i përgjigjeve negative (12%), gjegjësisht të anketuarit të cilët nuk pajtohen, vërehet lidhur me atë nëse të rinjtë duhet të mësojnë secila është rëndësia nga dhënia e pëlqimit gjatë hyrjes në marrëdhënie seksuale, veçanërisht gjatë marrëdhënies së parë. Edhe krahas asaj se nuk janë vërejtur dallime të konsiderueshme statistikore lidhur me strukturën demografike të anketuarve të cilët nuk pajtohen që

kjo temë të jetë pjesë e programit mësimor shkollor, megjithatë analiza e të dhënave demografike mund të merret si indikacion se numri më i madh i prindërve të cilët negativisht janë deklaruar janë nga grupi etnik shqiptar dhe grupet etnike tjera se sa maqedonasit, pastaj ata të cilët jetojnë në regjionin e Pollogut, si dhe prindërit ose kujdestarët me arsimim të përfunduar fillor në krahasim me ata me shkallë më të lartë të arsimit.

Në vazhdim vijon Tabela 1 me rezultatet nga hulumtimi sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike për të gjitha 12 temat e shqyrtuara.

SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILAT NGA TEMAT QË VIJOJNË TË RINJTË DUHET T'I MËSOJNË NË SHKOLLË, E CILAT JO?		GJITHSEJ	GJINIA E TË ANKETUARIT		PËRKATËSIA ETNIKE		
			MASHKULL	FEMËR	MAQEDONAS/E	SHQIPTAR/E	TJETËR
Të mësojnë se cilat janë dallimet mes femrave dhe meshkujve dhe çfarë do të thotë trajtim i barabartë dhe barazia	PO	92 %	91 %	93 %	92 %	94 %	91 %
	JO	8 %	9 %	7 %	8 %	6 %	9 %
Të njohin se si vendosen lidhje të shëndetshme partnere në bazë të respektit, ndërsa cilat lidhje janë të dëmshme për adoleshentët	PO	92 %	92 %	92 %	92 %	94 %	87 %
	JO	8 %	8 %	8 %	8 %	6 %	13 %
Të dinë se cila është rëndësia nga dhënia e pëlqimit gjatë hyrjes në marrëdhënie seksuale, veçanërisht gjatë marrëdhënies së parë	PO	88 %	87 %	89 %	90 %	81 %	70 %
	JO	12 %	13 %	11 %	10 %	19 %	30 %

SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILAT NGA TEMAT QË VIJOJNË TË RINJTË DUHET T'I MËSOJNË NË SHKOLLË, E CILAT JO?		GJITHSEJ	GJINIA E TË ANKETUARIT		PËRKATËSIA ETNIKE		
			MASHKULL	FEMËR	MAQEDONAS/E	SHQIPTAR/E	TJETËR
Të mësojnë se cilat ndryshime trupore ndodhin te të dy gjinitë gjatë pubertetit	PO	95 %	95 %	94 %	95 %	94 %	91 %
	JO	5 %	5 %	6 %	5 %	6 %	9 %
Të dinë se si të drejtohen për ndihmë mjekësore në rast të rrezikut nga HIV dhe infektimet seksualisht të transmetueshme	PO	96 %	96 %	95 %	96 %	95 %	89 %
	JO	4 %	4 %	5 %	4 %	5 %	11 %
Të mësojnë për kontracepsionin që të mbrohen nga shtatzënia e padëshiruar	PO	94 %	95 %	93 %	95 %	92 %	89 %
	JO	6 %	5 %	7 %	5 %	8 %	11 %
Të kuptojnë se lidhjet seksuale, dëshirat dhe kënaqësia janë dukuri të natyrshme, e jo të turpshme	PO	92 %	93 %	92 %	94 %	85 %	91 %
	JO	8 %	7 %	8 %	6 %	15 %	9 %
Të dinë se si të ballafaqohen me presionet nga mjedisi që të kenë marrëdhënie seksuale	PO	92 %	92 %	91 %	93 %	86 %	89 %
	JO	8 %	8 %	9 %	7 %	14 %	11 %
Të mësojnë për format e ndryshme të dhunës dhe se dhuna, veçanërisht ndaj vajzave, ka pasoja ndaj gjithë shoqërisë	PO	96 %	97 %	95 %	96 %	95 %	91 %
	JO	4 %	3 %	5 %	4 %	5 %	9 %
Të mësojnë se si të mbrohen nga dhuna seksuale në jetën e përditshme dhe dhunën në rrjetet sociale	PO	96 %	97 %	95 %	97 %	93 %	89 %
	JO	4 %	3 %	5 %	3 %	7 %	11 %
Të dinë si të reagojnë dhe kujt t'i drejtohen kur të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese janë kërcënuar	PO	95 %	95 %	94 %	96 %	91 %	89 %
	JO	5 %	5 %	6 %	4 %	9 %	11 %
Të dinë se cilat janë pasojat individuale dhe shoqërore nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual	PO	91 %	90 %	91 %	91 %	90 %	83 %
	JO	9 %	10 %	9 %	9 %	10 %	17 %

Tabela 1: Rezultatet nga hulumtimi sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike për të gjitha 12 temat e shqyrtuara

CVërehet se të dy temat të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e të rinjve në jetën e përditshme, gjegjësisht mbrojtjen nga çfarëdo lloj dhune, duke përfshirë edhe atë seksuale, si dhe lidhur me shëndetin e të rinjve, janë më të pranueshme për pjesën më të madhe (96%) nga të anketuarit, prindërit dhe/ose kujdestarët e fëmijëve të moshës deri në 15 vjet, si tema për t'i mësuar në shkollë. Përqindje e njëjtë e të anketuarve mendojnë se të rinjtë duhet të dinë dhe se ku të drejtohen për ndihmë mjekësore në rast të rrezikut nga HIV dhe infektimet seksualisht të transmetueshme.

Analiza sipas variabileve demografik për secilën nga temat të cilat ishin subjekt i këtij hulumtimi tregojnë se mendimi i prindërve dhe kujdestarëve të fëmijëve të moshës deri në 15 vjet, nuk varet nga gjinia e tyre, mjedisi ku jetojnë, moshja, regjioni dhe arsimimi. Lidhur me një të temave, dallime të konsiderueshme të caktuara statistikore² vërehen në mendimin e të anketuarve lidhur me përkatësinë e tyre etnike (Tabela 2), dhe atë:


TEMA	DALLIME TË KONSIDERUESHME STATISTIKORE (PO, të rinjtë duhet të mësojnë në shkollë)
1 Të dinë se cila është rëndësia nga dhënia e pëlqimit gjatë hyrjes në marrëdhënie seksuale, veçanërisht gjatë marrëdhënies së parë	Të anketuarit e përkatësisë etnike maqedonase (90%) dukshëm më shumë mendojnë se të rinjtë duhet të mësojnë për këtë temë në shkollë se sa ata nga përkatësia etnike shqiptare (81%), gjegjësisht përkatësisë tjera etnike (70%).
2 Të kuptojnë se lidhjet seksuale, dëshirat dhe kënaqësia janë dukuri të natyrshme, e jo të turpshme	Të anketuarit maqedonas (94 %) dukshëm më shumë mendojnë se të rinjtë duhet të mësojnë për këtë temë në shkollë se sa të anketuarit e përkatësisë etnike shqiptare (85%).
3 Të dinë se si të ballafaqohen me presionet nga mjedisi që të kenë marrëdhënie seksuale	Të anketuarit shqiptarë (93 %) dukshëm më shumë mendojnë se të rinjtë duhet të mësojnë për këtë temë në shkollë se sa të anketuarit e përkatësisë etnike maqedonase (86%).
4 Të mësojnë se si të mbrohen nga dhuna seksuale në jetën e përditshme dhe dhunën në rrjetet sociale	Të anketuarit e përkatësisë etnike maqedonase (97 %) dukshëm më shumë mendojnë se të rinjtë duhet të mësojnë për këtë temë në shkollë se sa shqiptarët (93%) dhe përkatësitë tjera etnike (89%).
5 Të dinë si të reagojnë dhe kujt t'i drejtohen kur të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese janë kërcënuar	Të anketuarit e përkatësisë etnike maqedonase (93%) dukshëm më shumë mendojnë se të rinjtë duhet të mësojnë për këtë temë në shkollë për dallim nga shqiptarët (86%).

Tabela 2: Dallime të konsiderueshme statistikore lidhur me variabilet demografike lidhur me temat për të cilat të anketuarit mendojnë se të rinjtë duhet t'i mësojnë në shkollë

² Dallime të konsiderueshme statistikore janë llogaritur si dallim i përqindjes së nivelit të rëndësisë 95 %.

Lidhur me 7 (shtatë) deklaratat e ofruara, shkalla më e lartë e pëlqimit të anketuarve (përgjigjet e kombinuara janë pajtohem dhe pajtohem plotësisht) vërehet lidhur me tre deklaratat që vijojnë (Grafiku 2):

- 1) Gruaja ka të drejtë të vendos nëse dhe me kë do të martohet ose jo - 97 %;
- 2) Përdorimi i kontracëpsionit është përgjegjësi e të dy partnerëve, e jo vetëm e vajzës – 94 %; dhe
- 3) Nëse nuk dëshiron, vajza ka të drejtë ta refuzojë marrëdhënien seksuale me të dashurin e saj – 93 %.




Grafiku 2: Shkalla e pëlqimit të anketuarve me deklaratat e ofruara - %

Lidhur me katër deklaratat tjera, vërehet shkallë më e ulët e pëlqimit të anketuarve, dhe atë:

- Homoseksualiteti është plotësisht i papranueshëm për më shumë se gjysma e të anketuarve (59%). Nga ana tjetër, rreth një e katërta (26%) janë me mendim të kundërt dhe nuk pajtohen me këtë, derisa 14% nuk kanë mendim për këtë temë.
- Një e treta e të anketuarve (34%) pajtohen se meshkujt janë ata të cilët kryesisht janë përgjegjës të fitojnë për familjen. Përkundër tyre, pothuaj gjysma (49%) nuk e ndajnë këtë mendim tradicional për rolin e mashkullit në familje.
- Lidhur me atë nëse vajzave u ngjan të masturbojnë, prindërit ose kujdestarët e anketuar kanë mendim të ndarë. Në të vërtetë, pothuaj përqindje e njëjtë e të anketuarve pajtohen (38%), gjegjësisht nuk pajtohen (36%) me këtë deklaratë. Përqindje e konsiderueshme (18%) është e atyre të cilët janë neutral lidhur me këtë dhe nuk kanë mendim.
- Rezultat i pritur nga hulumtimi tregon shkallë të lartë të papranueshmërisë së dhunës mbi gruan nga ana e mashkullit. Në të vërtetë, 94% të anketuarve nuk pajtohen se në raste të caktuara, është e arsyeshme që mashkulli ta rrahe gruan e tij. Edhe pse, dukshëm më pak të anketuar, megjithatë duhet të vërehet se rreth 4% të anketuarve pajtohen se dhuna mbi gratë është e arsyeshme në raste të caktuara.

Analizë shtesë dhe rrëfim grafik (Grafiku 3) të vlerave mesatare për secilën nga shtatë temat qartë e ilustrjnë shkallën e pëlqimit të anketuarve në hulumtim, që paraprakisht është analizuar përmes përqindjeve.



Grafiku 3: Shkalla e pëlqimit të anketuarve me deklaratat e ofruara – vlerësime mesatare

Me qëllim që të fitohet fotografi më e hollësishme për qëndrimet e të anketuarve, për secilën nga shtatë temat e bëra janë analizat e përgjigjeve dhe rreth karakteristikave të tyre të ndryshme demografike. Në vazhdim vijon analiza e dallimeve të konsiderueshme statistikore për secilën nga temat (Tabela 3). Atje ku nuk janë detektuar dallime të konsiderueshme statistikore, janë dhënë vlerësimet sipas gjinisë, mjedisit të banimit dhe përkatësisë etnike.

DEKLARATA		DALLIMET TË KONSIDERUESHME STATISTIKORE Pajtohen	DALLIME TË KONSIDERUESHME STATISTIKORE Nuk pajtohem
1	Meshkujt janë ata që kryesisht janë përgjegjës që të fitojnë për familjen	Me këtë deklaratë më shumë pajtohen meshkujt (43 %) se sa femrat (27 %); të anketuarit nga mjediset rurale (44 %) në krahasim me ata në mjediset urbane (28 %); shqiptarët (61 %) dhe të anketuarit nga etnikumet tjera (61 %) në krahasim me maqedonasit (29 %).	Me këtë deklaratë dukshëm më shumë nuk pajtohen femrat (59 %) se sa meshkujt (38 %); të anketuarit nga mjediset urbane (56 %) në krahasim me ata nga mjediset rurale (40 %), maqedonasit (54 %) në krahasim me shqiptarët (26 %) dhe të anketuarit e grupeve tjera etnike (30 %).
2	Gruaja ka të drejtë nëse dhe me kë do të martohet ose jo	Analiza tregon pëlqim dukshëm më të madh me këtë deklaratë te maqedonasit (98 %) se sa te grupet tjera etnike (Shqiptarët: 94 %, të tjerë: 95 %)	Nuk ka dallime të konsiderueshme statistikore (Meshkujt – 1 %, Femrat – 1 %; mjedisi urban – 0 %, mjedisi rural – 2 %; maqedonasit – 1 %, shqiptarët – 3 %, etnikumet tjera – 2 %)
3	Nëse nuk dëshiron, vajza ka të drejtë ta refuzojë marrëdhënien seksuale me të dashurin e saj	Femrat (94 %) dukshëm më shumë se sa meshkujt (91 %) pajtohen me këtë deklaratë, si edhe të anketuarit nga mjediset urbane (96 %) në krahasim me ata nga mjediset rurale (90 %), maqedonasit (96 %) dhe të anketuarit nga etnikumet tjera (91 %) në krahasim me shqiptarët (77 %).	Nuk ka dallime të konsiderueshme statistikore (meshkujt – 5 %, femrat – 2 %; mjedisi urban – 3 %, mjedisi rural – 5 %; maqedonasit – 2 %, shqiptarët – 16 %, etnikumet tjera – 7 %)
4	Përdorimi i kontracepsionit është përgjegjësi e të dy partnerëve, e jo vetëm e vajzës	Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se të anketuarit nga vendbanimet urbane (96 %) më shumë pajtohen me këtë deklaratë se sa ato nga vendbanimet rurale (93 %), si dhe të anketuarit maqedonas (96 %) në krahasim me shqiptarët (85 %).	Nuk ka dallime të konsiderueshme statistikore (meshkujt – 2 %, femrat – 3 %; mjedisi urban – 2 %, mjedisi rural – 3 %; maqedonasit – 2 %, shqiptarët – 7 %, etnikumet tjera – 2 %)
5	Vajzave nuk u ngjan të masturbojnë	Të anketuarit nga vendbanimet rurale (40 %) në numë dukshëm më të madh pajtohen me këtë deklaratë nga ata në vendbanimet urbane (33 %), si edhe të anketuarit shqiptarë (47 %) në krahasim me maqedonasit (34 %).	Analiza tregon se dukshëm më shumë të anketuarit të cilët jetojnë në mjediset urbane (44 %) nuk pajtohen me këtë deklaratë se sa ata nga vendbanimet rurale (31 %). E njëjta vërehet edhe te të anketuarit maqedonas (40%) në krahasim me shqiptarët (27 %).
6	Në raste të caktuara është e arsyeshme që mashkulli ta rrahë gruan	Nuk ka dallime të konsiderueshme statistikore (meshkujt – 6 %, femrat – 3 %; mjedisi urban – 3 %, mjedisi rural – 6 %; maqedonasit – 3 %, shqiptarët – 7 %, etnikumet tjera – 8 %)	Përqindje dukshëm më e madhe e femrave (96 %) se sa meshkujt (91 %) nuk pajtohen me këtë deklaratë, si edhe të anketuarit nga vendbanimet urbane (96 %) në krahasim me ata nga vendbanimet rurale (91 %).
7	Homoseksualiteti është plotësisht i papranueshëm	Analiza tregon se meshkujt (65 %) dukshëm më shumë pajtohen me këtë deklaratë se sa femrat (53 %), të anketuarit nga vendbanimet rurale (65 %) në krahasim me ata në vendbanimet urbane (54 %), shqiptarët (77 %) në krahasim me maqedonasit (56 %) dhe grupet tjera etnike (59 %), si dhe të anketuarit me shkallë më të ulët arsimimi (fillor: 70 %, të mesëm: 67 %) në krahasim me ata me shkallë më të lartë të arsimimit (të lartë: 44 %, fakultet: 45 %).	Përqindje e madhe e konsiderueshme e grave (30 %) se sa meshkujt (22 %) nuk pajtohen me këtë deklaratë, të anketuarit nga vendbanimet urbane (30 %) në krahasim me ata nga vendbanimet rurale (21 %).

Tabela 3: Dallim të konsiderueshme statistikore në pajtim me karakteristikat demografike lidhur me shkallën e pëlqimit të anketuarve me deklaratat e ofruara



4 METODOLOGJIA

Me qëllim të zbatimit të suksesshëm të këtij hulumtimi telefonik, Indago i zbatoi aktivitetet/fazat që vijojnë:

1. Finalizimi i pyetëtorit;
2. Krijimi i ekzemplarit;
3. Programimi i pyetëtorit në softuerin KATI (CATI - computer-assisted telephone interview – intervistë me telefon me ndihmën e kompjuterit);
4. Trajnim i intervistuesve;
5. Grumbullimi i të dhënave dhe mbikëqyrja;
6. Kontrolli logjik, krijimi i bazës të dhënave (SPSS);
7. Raport me analizë përshkruese të variabileve.

NË VAZHDIM VIJON PËRSHKRIMI I ÇDO AKTIVITETI/FAZE.

01

FINALIZIMI I PYETËSORIT

Indago e shqyrtoi dhe e përshtati për programim dhe pyetësin e përgatiti në bashkëpunim me HERA.

02

KRIJIMI I EKZEMPLARIT

Arsyeja kryesore për krijimin e ekzemplarit për hulumtimin sasior është të bëhen përfundime të përgjithshme për një grup më të madh, heterogjen (në rastin e këtij projekti, prindërit e fëmijëve në sistemin arsimor) me anketimin e një pjese më të vogël të grupit. Për nevojat e këtij projekti, Indago përgatiti ekzemplar kombëtar reprezentues me shfrytëzimin e ekzemplarit shumë shkallor. Përfaqësuesit e grupit qëllimor u fituan me ndihmën e metodologjisë për kornizë zë dyfishtë për përgatitjen e ekzemplarit me telefon.

Metoda telefonike për krijimin e ekzemplarit për krijimin e shembujve për kornizë të dyfishtë (fikse dhe celulare)

Krijimi i ekzemplarit për telefoninë fikse

Nga secili grup zgjidhet ekzemplar i veçantë, me zgjedhje të rastësishme në suaza të fushës gjeografike (d.m.th. për Manastirin prefiksi +389 47). Këto kode më tej janë të kufizuar në 100 deri prej numrave për të cilët dihet se përmbajnë amvisëri. Baza e ekzemplarëve me numër të rastësishëm (ENR, ose RDD - random digit dialing) për telefonat fiks i përmban të gjitha kodet fikse telefonike në shtet. Ekzemplari me numrin e rastësishëm (ENR) është ekzemplar statistikor i përgatitur për hulumtimin, ku të gjithë numrat e amvisërive, kanë gjasa të barabarta dhe reprezentative që të intervistohen. Baza e këtyre ekzemplarëve i përfshinë të gjitha amvisëritë, pa dallim nëse gjenden në adresarin e telefonit ose jo.

Krijimi i ekzemplarit për telefoninë celulare

Gjithashtu, ekzemplari i celularit me numër të rastësishëm është krijuar që të fitohen numrat celular nga amvisëritë pa lidhje të telefonisë fikse. Vlerësohet se afër 1/3 e amvisërive në vend nuk kanë linjë fikse dhe prandaj nuk janë të kapshëm në atë mënyrë. ENR i celularit është ekzemplar telefonik i cili rastësisht është zgjedhur në suaza të mijëra serive të blloqeve kushtuar sigurimit të shërbimit celular. Baza mobile e të dhënave për ENR i përmban të gjitha seritë mobile nga mijëra seri blloqe në vend. Pasi që numrat telefonik të celularëve nuk janë organizuar sipas gjeografisë, studimi së pari filloi me intervista me telefoninë mobile, pas çka vijoi intervista me telefonat fiks. Raporti i intervistave të zbatuara në linjën fikse dhe mobile është 80 : 20.

03

PROGRAMIMI I PYETËSORIT NË SOFTUERIN KATI (CATI – COMPUTER-ASSISTED TELEPHONE INTERVIEW – INTERVISTË TELEFONIKE ME NDIHMËN E KOMPJUTERIT)

Pas finalizimit, pyetësi u programua në softuerin KATI, me çka u mundësua i gjithë procesi i intervistës të jetë më efikas dhe më eficientë.

04

TRAJNIMI INTERVISTUESVE

Për nevojat e këtij hulumtimi, Indago formoi ekip të intervistuesve të cilët punuan në grumbullimin e të dhënave.

Me qëllim që intervistuesit në mënyrë sa më efektive t'i grumbullojnë të dhënat për këtë hulumtim, Indago organizoi trajnim. Trajnimi kishte për qëllim njoftimin me qëllimet e projektit, me pyetësin dhe me procedurat për zgjedhje të anketuarit. Po ashtu, trajnimi shërbeu për t'u sqaruar të gjitha aspektet dhe nuancat e çdo pyetjeje dhe vendet e mundshme të cilat mund të vijë deri te moskuptimi nga ana e të anketuarit, nëse ka të tilla, me qëllim që të shmangen gjatë intervistës.

05

GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE DHE MBIKËQYRJA

Indago zbatoi kontroll të cilësisë së grumbullimit të dhënave sipas Udhëzuesit për kontroll të cilësisë të lëshuar nga ESOMAR.³

Në rast të intervistës telefonike u zbatuan dy tipa të mbikëqyrjes: 1) gjatë intervistës telefonike dhe 2) përmes kontrollit telefonik (telephone back-check). Ekipi i mbikëqyrësve, të cilët po ashtu ishin trajnuar për këtë hulumtim konkret, ishin përgjegjës për mbikëqyrje të grumbullimit të dhënave.

Si plotësim i mbikëqyrjes gjatë vetë intervistës telefonike, Indago zbatoi edhe kontroll telefonik të 1-0% të intervistave të bëra nga secili intervistues. Si minimum, masat për kontroll të cilësisë përfshinë verifikim të: faktit se intervista është kryer me të vërtetë, zgjedhje adekuate e të anketuarit, gjatësia e intervistës, si dhe informatë për respektimin e përgjithshëm të standardeve profesionale nga ana e intervistuesit.

06

KONTROLLI LOGJIK DHE KRIJIMI I BAZËS TË DHËNAVE

Të dhënat e grumbulluara u transferuan në SPSS bazën e të dhënave (SPSS), pas çka u zbatua kontroll logjik. Kontrolli përbëhej prej analizës së lidhshmërisë logjike të përgjigjeve të fituara nga të anketuarit. Ajo zbatohet në pëlqim me procedurën standarde të caktuar me procedurat e brendshme për cilësi të Indago. Qëllimi i kontrollit logjik është të verifikohet: rregullshmëria e zgjedhjes së anketuarit në pajtim me procedurën e hartuar për zgjedhje të rastësishme dhe kontakt-procedura, si dhe shkalla e përgjigjeve në pyetësor.

Pas regjistrimit të dhënave në SPSS dhe pas kontrollit të përfunduar të plotë logjik, të dhënat u kryqëzuan sipas të gjitha variabileve demografike.

07

RAPORT ME ANALIZË PËRSHKRUESE TË VARIABILEVE

Pas kryqëzimit të dhënave, Indago përgatiti raport në gjuhën maqedonase me rëfim grafik dhe analizë përshkruese të variabileve.

³ ESOMAR – European Society for Opinion and Marketing Research, <http://www.esomar.org/>

5 STRUKTURA E VARIABILEVE

Tabela 4 që është dhënë në vazhdim i përmban t gjitha informatat për strukturën e ekzemplarit sipas karakteristikave demografike.



REGJIONI	i Vardarit	6,0 %
	Lindor	10,0 %
	Jugperëndimor	11,0 %
	Juglindor	9,0 %
	i Pellagonisë	12,0 %
	i Pollogut	14,0 %
	Verilindor	9,0 %
	i Shkupit	29,0 %
MJEDISI I BANIMIT	Urban	57,0 %
	Rural	43,0 %
PËRKATËSIA ETNIKE	Maqedonas/e	81,9 %
	Shqiptar/e	12,0 %
	Tjetër	6,0 %
GJINIA	Mashkullore	47,3 %
	Femërore	52,7 %
MOSHA	18 – 24	1,8 %
	25 – 34	22,9 %
	35 – 44	52,0 %
	45 – 55	20,3 %
	56 – 65	2,7 %
	Më shumë se 65	0,2 %
ARSIMIMI	Nuk ka arsimim dhe arsim fillor i papërfunduar	0,4 %
	Arsimi fillor	6,4 %
	Arsimi i mesëm	47,0 %
	Arsimi i lartë	6,3 %
	Fakultet	36,2 %
	Magjistraturë/Doktoraturë	3,4 %
	Refuzon të përgjigjet	0,4 %

Tabela 4: Struktura e ekzemplarit

6 INSTRUMENTI PËR HULUMTIMIN – PYETËSORI

PYETËSOR

HULUMTIM I MENDIMIT PUBLIK MES PRINDËRVE PËR TEMA TË CILAT TË RINJTË DUHET T’I MËSOJNË NË SHKOLLË

Grumbullimi i të dhënave

Fillimi: 27 qershor 2019

Përfundimi: 10 korrik 2019

I. MADHËSIA E EKZEMPLARIT

Gjithsej n = 800 intervista, me prindër ose kujdestar të fëmijëve të moshës deri në 15 vjet

II. HYRJE

Mirëmëngjesi/Mirëdita/Mirëmbërma. Unë quhem ... dhe punoj për agjencinë Indago për hulumtim të tregut dhe mendimit publik. Për momentin zbatojmë hulumtim për qëndrimet dhe mendimet tuaja për përfshirjen e përbajtjeve të reja ose lëndës zgjedhore në mësim. Nëse keni 10 minuta kohë që t’u përgjigjeni disa pyetjeve? Përgjigjet tuaja kanë rëndësi të madhe për ne. Të gjitha përgjigjet janë anonime, ndërsa të dhënat përdoren vetëm për analiza statistikore. A mund të fillojmë me pyetjet?

III. ZGJEDHJA E AMVISËRISË

S01 [S]

Në amvisërinë tuaj a keni fëmijë të moshës deri në 15 vjet?

1. Po
2. Jo → FUND (SCREENOUT)

IV. ZGJEDHJA E TË ANKETUARIT/ANKETUARËS

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT TË CILËT JANË PËRGJIGJUR 1. NË S01

A01 [S]

Në çfarë lidhje jeni me fëmijën /fëmijët të moshës deri në 15 vjet?

1. Nëna
2. Babai
3. Kujdestari
4. Tjetër (ANK. Kërko të bisedosh me prindin ose kujdestarin. Nëse nuk janë për momentin në shtëpi, caktoni intervistën në kohë tjetër kur do të jenë në shtëpi. Nëse edhe kjo nuk është e mundur, përfundoni intervistën). → FUND (SCREENOUT)

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT TË CILËT JANË PËRGJIGJUR 1., 2. OSE 3. NË S02

A02 [S]

Regjioni

1. I Shkupit
2. I Pollogut
3. I Vardarit
4. Lindor
5. Verilindor
6. Juglindor
7. Jugperëndimor
8. I Pellagonisë

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT TË CILËT JANË PËRGJIGJUR 1., 2. SE 3. NË S02

A08 [S]

Mjedisi i banimit?

1. Urban
2. Rural

V. PYETËSORI KRYESOR

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT

A03 [S per row] (ANK. Është e mundur një përgjigje për një deklaratë)

Do t'ju lexoj disa tema. Sipas mendimit Tuaj, çfarë prej tyre të rinjtë duhet të mësojnë në shkollë, e çfarë nuk duhet?

TEMAT	PO (1)	JO (2)
1. Të mësojnë se cilat janë dallimet mes femrës dhe mashkullit dhe çfarë do të thotë trajtim i barabartë dhe barazia	1	2
2. Të njohin se si vendosen lidhje të shëndetshme partnere të bazuara mbi respektin, e cilat lidhje janë të dëmshme për adoleshentët	1	2
3. Të dinë cila është rëndësia e dhënies pëlqim gjatë hyrjes në marrëdhënie seksuale, veçanërisht gjatë të parit	1	2
4. Të mësojnë çfarë ndryshimesh trupore ndodhin te të dy gjinitë gjatë pubertetit	1	2
5. Të dinë se ku të drejtohen për ndihmë mjekësore në rast të rrezikut nga HIV dhe infektimet seksualisht të transmetueshme	1	2
6. Të mësojnë për kontracepsionin që të mbrohen nga shtatzënia e padëshiruar	1	2
7. Të kuptojnë se lidhjet seksuale, dëshirat dhe kënaqësia janë dukuri të natyrshme, e jo të turpshme	1	2
8. Të dinë se si të ballafaqohen me presionet nga mjedisi që të kenë marrëdhënie seksuale	1	2
9. Të mësojnë për format e ndryshme të dhunës dhe se dhuna, veçanërisht ndaj vajzave, ka pasoja ndaj gjithë shoqërisë	1	2
10. Të mësojnë se si të mbrohen nga dhuna seksuale në jetën e përditshme dhe dhunën në rrjetet sociale	1	2
11. Të dinë si të reagojnë dhe kujt t'i drejtohen kur të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese janë kërcënuar	1	2
12. Të dinë se cilat janë pasojat individuale dhe shoqërore nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual	1	2

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT

A04 [S per row] (ANK. Është e mundur një përgjigje për një deklaratë)

Me përdorimin e shkallës prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë Nuk pajtohem aspak, ndërsa 5 Pajtohem plotësisht, deri në cilën masë pajtoheni ose nuk pajtoheni me deklaratat që vijojnë:

	Nuk pajtohem aspak	Pajtohem	Nuk kam mendim	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di /Refuzon të përgjigjet(MOS LEXO)
1. Meshkujt janë ata të cilët kryesisht janë përgjegjës që të fitojnë për familjen	1	2	3	4	5	6
2. Gruaja ka të drejtë të vendos nëse dhe me kë do të martohet ose jo	1	2	3	4	5	6
3. Nëse nuk dëshiron, vajza ka të drejtë ta refuzojë marrëdhënien seksuale me të dashurin e saj	1	2	3	4	5	6
4. Përdorimi i kontracepsionit është përgjegjësi e të dy partnerëve, jo vetëm e vajzës	1	2	3	4	5	6
5. Vajzave nuk u ngjan të masturbojnë	1	2	3	4	5	6
6. Në raste të caktuara është e arsyeshme që mashkulli ta rrahë gruan	1	2	3	4	5	6
7. Homoseksualiteti është tërësisht i papranueshëm	1	2	3	4	5	6

VI. DEMOGRAFIA

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT

A05 [S]

Gjinia e të anketuarit

1. Mashkull
2. Femër

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT

A06 [S]

Sa vjeçar jeni? ----- vjet

(ANK: Shënoni vitet dhe kontrolloni kategorinë e moshës)

1. Më pak se 18
2. 18 – 24
3. 25 – 34
4. 35 – 44
5. 45 – 55
6. 56 – 65
7. Më shumë se 65

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT

A07 [S]

Cila është përkatësia juaj etnike?

1. Maqedonas/e
2. Shqiptar/e
3. Tjetër (ANK: shkruaj) _____

BAZA: TË GJITHË TË ANKETUARIT

A09 [S]

Shkalla më e lartë e arsimimit?

1. Nuk ka arsimim dhe arsim fillor i papërfunduar
2. Arsim fillor
3. Arsim i mesëm
4. Arsim i lartë
5. Fakultet
6. Magjistraturë/Doktoraturë
7. Refuzon të përgjigjet (MOS LEXO)

SCREENOUT

Ju faleminderit për pjesëmarrjen, por për fat të keq, profili juaj nuk i përgjigjet grupi qëllimor të hulumtimit.

FUND I ANKETËS

Ju faleminderit për pjesëmarrjen!



A Member Association of



IPPF

International
Planned Parenthood
Federation

European Network

